



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 22 /2026
Datë: 10/03/2026

Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 3, nën paragrafi pika 3.6) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe në pajtim me nenin 8 të Rregullores Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Zyrtarët e emëruar me akt emërimi në Departamentin për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, fushëveprimi i të cilëve ka qenë në Ministrinë e Drejtësisë, kalojnë si të punësuar në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare.
2. Lista e zyrtarëve të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi bashkëngjitet si shtojcë e tij.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me hyrjen në fuqi të Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, kompetencat në fushën e politikave të shërbimeve sociale dhe familjare janë përcaktuar në kuadër të përgjegjësisë administrative të Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare.

Deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, zyrtarët kanë ushtruar detyrat e tyre në Departamentin për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Për shkak të ndryshimit të kompetencave administrative të ministrive dhe me qëllim të harmonizimit të sistemit të stafit me fushëveprimet aktuale institucionale, zyrtarët e këtij departamenti transferohen në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, në përputhje me Rregulloren Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të

Ministrive, me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt dhe vazhdimësisë së shërbimeve publike.


Anita KALANDERI
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i dërgohet:

- Zyrtarëve të Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Kabinetit Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

Departamenti për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare			
1	Blerim	Shabani	Drejtor i Departamentit të Politikave të shërbimeve Sociale dhe familjare
Divizioni për Inspektimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare			
2	Fitore	Rexhaj	Udhëheqëse e Divizionit për Inspektim të shërbimeve Sociale dhe Familjare
3	Valbona	Mujota	Zyrtar i Lartë për Inspektimin e shërbimeve Sociale
4	Ylfete	Abazi	Zyrtar i lartë për inspektimin e shërbimeve familjare
5	Venera	Ramadani	Zyrtar për inspektimin e shërbimeve sociale dhe familjare
Divizioni për Mbrojtje të Fëmijëve dhe të Rinjve			
6	Magbule	Koci	Udhëheqëse e Divizionit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve
7	Bardhyl	Plakolli	Zyrtar për mbrojtje të fëmijëve dhe të rinjve
Divizioni për Planifikim, Licencim dhe Trajnim			
8	Skender	Jahaj	Udhëheqës i Divizionit për Planifikim, Licencim dhe Trajtime
9	Ilir	Mazreku	Zyrtar i lartë për planifikim
10	Sokol	Krasniqi	Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave
11	Ganimete	Shala	Zyrtar i lartë për trajnime
12	Ylber	Kokollari	Zyrtar i lartë për Licencim
13	Liridon	Sadiku	Zyrtar për Planifikim, Licencim dhe Trajtime
Divizioni për Shërbime Sociale dhe Familjare			
14	Adile	Shaqiri	Udhëheqëse e Divizionit të Shërbimeve Sociale
15	Fahrije	Ajeti	Zyrtar I larte për Shërbime Sociale
16	Shqipe	Prekaj	Zyrtar i Lartë për Shërbime Sociale
17	Nafije	Selimi	Zyrtar i Lartë për Shërbime Sociale
18	Ganimete	Murseli	Zyrtar i Lartë për Shërbime Sociale
19	Lutfi	Bislimi	Zyrtar i Lartë për Shërbime Sociale